

342.727

Burhanedin Nuhiju<sup>1</sup>

**E DREJTA PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONET  
ME KARAKTER PUBLIK**

**ПРАВОТО НА СЛОБОДЕН ПРИСТАП НА ИНФОРМАЦИИ  
ОД ЈАВЕН КАРАКТЕР**

**THE RIGHT TO FREE ACCES TO PUBLIC INFORMATION**

**Abstract**

The right to free access to public information, is a relatively new topic, having in mind the fact that the institutional policies on this right, almost in all developed and democratic countries, have appeared very late, with the exception of Sweden where with the passing of the Law on freedom of press in 1766, the right to free access to information of public nature was regulated by law.

Free access is a product of the democratization of juridical systems, and a key means in the reformation process of the public administration.

The opportunity for citizens to seek and obtain information on the work of their governments is a must for the transparency and accountability, which are signs of democracy and open societies.

The right to free access to public information is a right that was denied to citizens in the past. This contributed to the increasing of corruption and the abuse of the people's money.

Having in mind that in the last few years this right has begun to be institutionalized in many countries, with special laws on the free access to public information, I felt it was important to write some sentences in this way.

**Key words:** free access, public institutions, researcher, comparative jurisprudence, possessor.

---

<sup>1</sup> Autori është magjistër i shkencave juridike dhe punon në Komunën e Studeniçanit, e-mail: burhanedin.nuhiju@live.com.

### **Abstrakt**

E drejta për qasje të lirë në informacionet me karakter publik është një tematikë kushtimisht thënë “e re” duke parur parasysh faktin se rregullimi institucional i kësaj të drejte në pothuajse të gjitha vendet e zhvilluara dhe demokratike paraqitet shumë vonë përveç Suedisë ku me sjelljen e Ligjit për lirin e shtypit në vitin 1766 juridikisht rregullohet edhe e drejta për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.

Qasja e lirë është prodhim i demokratizimit të sistemeve juridike, si dhe mjet kyç në procesin e reformimit të administratës publike. Mundësia që qytetarët të kërkojnë dhe të marrin informacione për punën e pushteteve të tyre është e patjetërsueshme për transparencën dhe përgjegjshmërinë, të cilat janë shenjë e demokracisë, përkatësisht shoqërive të hapura.

E drejta për qasje të lirë në informacionet me karakter publik paraqet një të drejtë e cila në të kaluarën u është mohuar qytetarëve nga ana e institucioneve publike, gjë e cila ka ndikuar në shtimin e korrupsionit dhe keqpërdorimeve të mjeteve të popullit.

Duke parur parasysh se viteve të fundit ka filluar të institucionalizohet kjo e drejtë në shumë vende të Botës, me Ligje të posaçme për qasjen e lirë në informacione me karakter publik ose me Ligje tjera ku përfshihet edhe qasja e lirë në informacionet me karakter publik, andaj e ndjeva të rëndësishme të shkruaj disa fjali në këtë drejtim.

**Fjalët kyçe:** Qasja e lirë, institucionet publike, kërkuesi, e drejta komparative, poseduesit.

### **Historiku i qasjes së lirë në informacione me karakter publik**

Suedia është vendi i parë në botë i cili e ka rregulluar apo institucionalizuar të drejtën e qasjes së lire në informacione me karakter publik me sjelljen e Ligjit për lirinë e shtypit në vitin 1766 brenda të cilit Ligj rregullohet edhe qasja e lirë në informacione me karakter publik andaj me plotë të drejtë mund të themi se Suedia është djep i qasjes së lirë në informacione me karakter publik.

Zhvillimin e lirisë së informimit, si e drejtë themelore njerëzore, në agjendën e vet të prioritetëve e vendosi Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në fillim të formimit të saj në vitin 1946. Në Rezolutën 59 (1), hasim këtë definicion: “Liria e informimit është e drejtë themelore njerëzore dhe bazë për të gjitha liritë për të cilat lufton Organizata e Kombeve të bashkuara”.

Një prej dokumenteve më të rëndësishme nga sfera e të drejtave të njeriut për vendet e Evropës është Konventa evropiane për të drejtat

e njeriut e Këshillit të Evropës, e vitit 1950. Në nenin 10 të kësaj Konvente thuhet:

“Çdo kush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë e pranimit e të transmetimit të informacioneve dhe ideve, pa u përzier pushteti publik dhe pa marrë parasysh kufijtë”<sup>2</sup>.

Numri i ligjeve për qasje të lirë në informacione viteve të fundit është rritur në mënyrë drastike dhe sot mbi 80 vende në botë kanë sjellë Ligj për qasje të lirë në informacione me karakter publik apo ndonjë Ligj tjetër në kuadër të të cilit rregullohet qasja e lirë në informacione me karakter publike.

Sjelljen e një Ligji të këtillë në shumë vende të zhvilluara dhe demokratike ka ardhur si nevojë e kohës për hapje ndaj opinionin, në disa vende si rezultat i hakmarrjeve të pushteteve aktuale ndaj atyre të kaluara<sup>3</sup>, në disa vende tjera si rezultat i presionit ndërkombëtar etj.

### **Definicioni i së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik dhe informacione të përgjithshme me theks të veçantë në republikën e maqedonisë**

#### 1. Definicioni dhe korniza juridike

Informacioni me karakter publik nënkupton informacion në çfarëdo forme qoftë që e ka krijuar ose që disponon poseduesi i informacioneve në pajtim me kompetencat e tij<sup>4</sup>.

E drejta për qasje të lirë në informacione në vendin tonë buron nga dispozita themelore e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë<sup>5</sup>. Së këndejmi, mospësigurimi i qasjes së lirë në informacione do të thotë edhe shkelje e Kushtetutës.

#### 2. Ligji për qasje të lirë në informacionet me karakter publik.

<sup>2</sup> Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, Council of Europe, Romë 04.XI.1950, [http://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_SQL.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_SQL.pdf).

<sup>3</sup> Edhe Ligji i parë në botë i cili rregullon këtë të drejtë ai suedez është sjellë si masë e pushtetit aktual me qëllim të hapjes së dosjeve të cilat pushteti i kaluar i kishte shpallur si të fshehta.

<sup>4</sup> Definicioni është shkrepur nga член 3 од Законот за слободен пристап до информации од јавен карактер (ЗСПИЈК) 2006, <https://members.slvesnik.com.mk/regulationdetails.aspx?regID=11588>.

<sup>5</sup> Neni 16: garantohet qasja e lirë në informacione, liria e pranimit dhe e transmetimit të informacioneve.

Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e votoi në janar 2006<sup>6</sup>, ndërsa implementimi i tij filloi me 01.09.2006. Ligji pësoi ndryshime në vitin 2008, ndryshime dhe plotësime në vitin 2010 si dhe në vitin 2014<sup>7</sup>. Ky Ligj i përcakton rregullat për qasjen në informacione me karakter publik.

Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik – rregullon mënyrën e realizimit të së drejtës për qasje të lirë apo më mirë thënë përmban dispozita për procedurën e nevojshme së cilës duhet kërkuesi dhe poseduesi i informacionit t'i përmbahen.

Ky Ligj e paraqet rregullativën juridike për lëndën e kësaj të drejte, realizimin e saj, mbrojtjen juridike etj. Me Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik janë definuar<sup>8</sup>:

- Lënda e së drejtës për qasje të lirë;
- Qëllimet nga realizimi i kësaj të drejte;
- Kush mund të jenë posedues të informacioneve;
- Obligimet e poseduesve të informacioneve;
- Procedurën për realizimin e kësaj të drejte;
- Qasja në informacione;
- Personi zyrtar për ndërmjetësim me informacione dhe obligimet e tij në korniza të kësaj të drejte;
- Gjuha në të cilën dorëzohet kërkesa;
- E drejta për mbrojtje juridike;
- Harxhimet për ndërmjetësim të informacioneve;
- Komisioni për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informacione;
- Informim i opinionit në lidhje me qasjen në informacione;
- Raportet vjetore<sup>9</sup>;

#### 2.1. Qëllimi i rregullimit

Qëllimi i rregullimit ligjor të së drejtës për qasje të lirë deri tek informacionet me karakter publik është, me këtë Ligj, të sigurohet hapuri dhe publicitet në punën e poseduesve të informacioneve dhe të ju mundësohet personave fizik dhe juridik ta realizojnë të drejtën për

<sup>6</sup> Службен весник на РМ бр.13/2006

<sup>7</sup> Службен весник на РМ бр.86/2008 и бр.6/2010, 42/2014.

<sup>8</sup> Павловска Данева Ана и Елена Давитковска, Право на слободен пристап до информации од јавен карактер, стр.79.

<sup>9</sup> Ibid.

qasje të lirë<sup>10</sup>. Kjo duhet të kontribuojë për transparencë dhe efikasitet të shërbimeve publike si dhe forcimit të besimit të qytetarëve ndaj punës së institucioneve publike.

### 3. Poseduesit e informacioneve dhe obligimet e tyre.

Posedues të informacioneve me karakter publik janë të gjithë organet dhe institucionet shtetërore (publike)<sup>11</sup>, drejtorit publike, ndërmarrjet publike, entet shtetërore, komunat, qyteti i Shkupi, komunat në qytetin e Shkupit personat fizik dhe juridik me autorizime publike, të përcaktuar me Ligj<sup>12</sup>.

#### Cilat janë obligimet e poseduesve të informacioneve?

➤ Çdo posedues i informacioneve duhet me akt të caktojë një ose më shumë persona zyrtarë për ndërmjetësim në lidhje me informacionet me karakter publik. Personi zyrtarë ka për obligim ta zbaton procedurën pas kërkesës për qasje të lirë, të ju ndihmon kërkuesve, me qëllim në mënyrë të thjeshtë dhe shpejtë, me pak harxhime dhe pa humbur shumë kohë, ta marrin informacionin e kërkuar me çka do ta realizojnë të drejtën e tyre të garantuar me kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe e operacionalizuar në Ligj. Caktimi i personit zyrtarë paraqet lehtësim për kërkuesin pasi që ai prej para e din se kush duhet të merret me kërkesën e tij. Personi zyrtar është i obliguar kërkuesit ti jep ndihmë gjatë plotësimit të kërkesës<sup>13</sup>.

➤ Për pranimin e kërkesave për informacione, ruajtjen dhe dhënien e informacioneve, personi zyrtarë mban evidencë të posaçme. Evidenca mbahet në fletore të zakonshme dhe do ti shërbejë personit zyrtarë për përgatitje më të lehtë të raportit vjetor<sup>14</sup>.

➤ Më shumë posedues të informacioneve mundën bashkërisht ta caktojnë një ose më shumë persona zyrtarë për ndërmjetësim gjatë realizimit të së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik<sup>15</sup>.

<sup>10</sup> Член 2 од ЗСПИЈК.

<sup>11</sup> Pushteti në RM është i ndarë në: ligjvënës (Kuvendi i RM-së, Këshilli i komunës), suprem (Qeveria, ministritë dhe organet e tjera të përcaktuara me Ligjin për qeverinë) dhe gjyqësor (Gjykata kushtetuese, supreme, administrativ, Gjykata e lartë administrative, prokuroria publike, avokati i popullit, gjykatat themelore).

<sup>12</sup> Definicioni në fjalë është dhënë duke u mbështetur në rregullimin ligjor në R.M.

<sup>13</sup> Член 8 став 1 од ЗСПИЈК и член 6 став 1 nga Упатство за начинот и постапката за спроведување на Законот за слободен пристап до информации од јавен карактер, <http://spinfo.org.mk/phocadownload/upatstvo.pdf>.

<sup>14</sup> Ibid. член 8 став 3, Ibid. член 6 став 2

<sup>15</sup> Ibid. член 8 став 4.

➤ Kërkuesit të ia mundësojë formularin për parashtrim të kërkesës i caktuar nga ana e Komisionit dhe ti sigurojë hapësirë për shikim në informata. Nuk është e domosdoshme që kërkuesi ta parashtojë kërkesën në formularin e caktuar nga Komisioni, kërkesën mundet ta parashtojë edhe në fletë të zakonshme por duhet patjetër të thirret në Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

➤ Të përgatitë listë të informacioneve me të cilat disponon dhe të njëjtën ta shpallë në vende që do të jetë lehtë i qasshëm për qytetarët (ueb faqe, tabelë për shpallje) që të mund qytetarët lehtë të informohen se me çfarë informacione disponon, dhe listën njëjtë ta azhurnojë rregullisht<sup>16</sup>.

➤ Të mundësojë qasje në informacione pa pagesë<sup>17</sup>.

➤ Në lidhje me zbatimin e Ligjit për qasje të lirë ka obligim të bashkëpunojë me poseduesit e tjerë dhe me Komisionin.

➤ Të përgatis raport vjetor për zbatimin e Ligjit prej 1 janarit deri më 31 dhjetor dhe të njëjtin ta dorëzojë deri te Komisioni deri më 31 janar në vitin aktual<sup>18</sup>.

➤ Si dhe obligimet e poseduesit të informacioneve në lidhje me të dhënat e përgjithshme, mënyrën si mund të arrin deri te informacioni etj.

### **Sfidat me të cilat ballafaqohet ligji**

Edhe pse Ligji për qasje të lirë në informacionet me karakter publik me disa plotësime dhe ndryshime të bëra<sup>19</sup> paraqet një Ligj të përgatitur mirë por problemi kryesor qëndron aty se Ligji në fjalë injorohet dhe ekzistojnë sfida serioze në lidhje me implementimin efikas të ligjit, ndërsa problemet në realizimin e ligjit nuk janë si rezultat i vet dispozitave dhe interpretimit të tyre, por para së gjithash janë rezultat i implementimit jo të përshtatshëm të obligimeve nga ana e institucioneve, të cilat janë ndoshta si rezultat i mosnjohjes së mirë të kornizës ligjore. Andaj dhe do të përmendim disa prej problemeve me të cilat ballafaqohemi në praktikë:

- Më shumë se gjysma e kërkesave nuk marrin asnjë lloj përgjigje (Heshtja e administratës)

<sup>16</sup> Ibid. член 9.

<sup>17</sup> Ibid. член 10 став 2.

<sup>18</sup> Raporti përfshin të gjitha kërkesat e parashtruara gjatë vitit kalendarik, përgjigjja e tyre, refuzimi etj.

<sup>19</sup> Ndryshime në vitet 2008, 2010 dhe 2014.

- Qasja në informacione duhet të jetë rregull e jo përjashtim (Informacionet që kërkohen duhet të jepen apo qytetarët të kenë qasje në to edhe në rastet kur informacioni bën pjesë në kategorinë e përjashtimeve, pasi që ligjvënësi ka caktuar obligim ndaj poseduesve të informacioneve në çdo rast konkret pra pas çdo kërkesë të analizojnë se interesi publik i shpalljes së këtij informacioni është më i madh se sa interesi i mbrojtur);


- Ligji parasheh edhe qasje të pjesërishtme (Ligji më saktësisht neni 7 i ligjit parasheh edhe qasje të pjesërishtme atje ku qasja e tërësishtme është e pamundshme por në praktikë thuhet se nuk kemi qasje të pjesërishtme pasi që poseduesit e informacioneve nuk e respektojnë këtë dispozitë ligjore);

- Afatet që janë dhënë në Ligj, edhe pse mjaftojnë për dhënie të përgjigjes, në shumicën e rasteve nuk respektohen;

- Mospasja njohuri për ekzistimin e Ligjit (Sipas një analize të bërë nga Instituti për shoqëri të hapur Maqedoni për vitet 2006 – 2010 tregon se më shumë se 2/3 (63%) e qytetarëve nuk e dinë se ekziston një ligj i këtillë<sup>20</sup>)

Në pyetjen se a e dini se ekziston Ligj për qasje të lirë në informacione me karakter publik?

Qytetarët janë përgjigjur:



<sup>20</sup> Анализа и наоди од наблудувањето на имплементацијата на Законот за слободен пристап до информации од јавен карактер (2006 – 2010) стр.6.

<sup>21</sup> Ibid. 12.

E nevojshme është që të bëhen fushata të ndryshme për informim të qytetarëve për ekzistimin e një Ligji të tillë dhe për të drejtat që atyre ua mundëson ky Ligj. Gjithashtu nevojitet trajnim më efikas i personave zyrtarë ndërmjetësues për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

Nga ana tjetër hulumtimi më i ri i vitit 2013<sup>22</sup> i realizuar nga Fondacioni për shoqëri të hapur Maqedoni tregon se një pjesë e madhe e qytetarëve nuk mendojnë se kanë të drejtë të kërkojnë informacione nga institucionet shtetërore. Qëndrimi i qytetarëve varet edhe nga lloji i institucionit nga i cili kërkojnë informacionet dhe nga çështja për çka bëhet fjalë në kërkesën për qasje<sup>23</sup>. Më i shpeshtë është rasti kur qytetarët mendojnë se nuk kanë të drejtë të kërkojnë informacione prej institucioneve të shëndetit publik dhe pushtetit shtetëror. Qytetarët definitivisht janë më të pa interesuar për informacionet që i posedon qeveria dhe ministritë. Këtu qytetarët janë të ndarë dhe gjysma aspak nuk kanë interesim për këtë lloj të informacioneve. Dy të tretat e qytetarëve interesohen për informacionet e komunave, arsimit dhe shëndetësisë, dhe pak më shumë për buxhetin dhe ndërmarrjet private me autorizime publik. Dhe më së shumti interesim kanë për çështje që kanë të bëjnë me ambientin jetësorë;

- Dispozitat për kundërvajtje - “fjalë në letër”.

### **Perspektivat**

Qasja e lirë në informacione me karakter publik është kusht për zhvillim të demokracisë në një shtet. Me dhënien e informacioneve të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se kontribuojmë në ndërtimin e një shoqërie më demokratike, antikorruptive dhe shoqëri e hapur ndaj qytetarëve. Ligji për qasje të lirë ndihmon që të marrim një trajtim më

<sup>22</sup> Надминување на принципите на тајност во работењето на администрацијата, извештај од спроведеното истражување за правото на слободен пристап до информации од јавен карактер, Фондација отворено општество Македонија ноември 2013.

<sup>23</sup> Pyetjet në të cilat janë përgjigjur qytetarët në lidhje me institucionet e caktuara dhe shembujt e llojeve të informacioneve të cilat i mbajnë ato informacione janë: ...a keni të drejtë personalisht të kërkon dokumente nga qeveria dhe ministritë, si për shembull procesverbale nga mbledhjet e qeverisë ose agjendat ditore për punën e ministrave ose qeverisë?

... a keni të drejtë personalisht të kërkon informacione të cilat i posedojnë komunat dhe ndërmarrjet publike, si p.sh. programe, plane, vendime rrogat e këshilltarëve komunal ose kryetarëve?



të mirë ndaj institucioneve, të kemi shërbime më efikase të kemi ekonomi më konkurruese. Në kohë të ndryshimeve të mëdha, si në nivel global ashtu edhe në nivel lokal, është e nevojshme që t'i ndërtojmë institucionet që të jenë të gatshme të aftësohet për ndryshimet e reja.

Prej sjelljes së Ligjit për qasje të lirë në vitin 2006 në Maqedoni kemi ndryshime të mëdha në qasjen e institucioneve ndaj qytetarëve. Dobitë janë të ndryshme duke filluar me atë se qytetarët kur të duan mund të parashtrojnë kërkesë për qasje të lirë në informacione me karakter publik për të cilën kërkesë organet shtetërore janë të detyruar ti përgjigjen, u rrit transparenca e organeve shtetërore, harxhime të mjeteve buxhetore më me kujdes, hapuri të organeve publike ndaj opinionit.

### **Komisioni për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik**

Komisioni për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik u themelua nga Kuvendi i RM-së me sjelljen e Ligjit për qasje të Lirë në informacione me karakter publik në vitin 2006<sup>24</sup>. Statusi i Komisionit nuk është i rregulluar si duhet me Ligj me vetë faktin se askund nuk përmendet nëse Komisioni është subjekt juridik, Komisioni nuk ka statutin e vet<sup>25</sup>, por vetëm ceket se Komisioni është organ i pavarur i cili raporton para Kuvendit të RM-së.

Kompetencat e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik dhe është i pavarur në punën e vet dhe sjelljen e vendimeve. Komisioni financohet nga buxheti i RM-së dhe përgatit raport vjetor për punën e vet të cilin e raporton para Kuvendit të RM-së. Poseduesi i informacioneve duhet që në fund të çdo viti kalendarik të përgatit raport vjetor për realizimin e këtij Ligji dhe të njëjtin ta dorëzon deri te Komisioni<sup>26</sup>.

Komisioni është i përbërë prej pesë anëtarëve, prej të cilëve njëri është kryetar, e tjetri zv. kryetar. Sipas Ligjit për qasje të lirë kryetarin, zv. kryetarin dhe anëtarët i emëron dhe shkarkon Kuvendi i Republikës

<sup>24</sup> Член 30 од ЗСИЈКП (Службен весник на РМ бр. 13/2006.

<sup>25</sup> Заклучок за прекинување на постапка по поднесено барање, бр. 08-2 од 01.04.2015 година, Комисија за заштита на правото на слободен пристап до информации од јавен карактер, во заклучокот наведено е дека Комисијата нема статут за што со закон не е обврзана.

<sup>26</sup> Павловска Данева Ана и Елена Давитковска, Право на слободен пристап до информации од јавен карактер, стр.109.

së Maqedonisë me propozim të Komisionit për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve, me mandat 5 vjeçar me të drejtë për rizgjedhje. Për emërimin e kryetarit të Komisionit, zv. kryetarit dhe anëtarëve Kuvendi i RM-së shpall konkurs publik<sup>27</sup>.

Edhe pse Komisioni financohet nga buxheti i RM-së, evidente është se për shkak të mjeteve qesharake me të cilat disponon, Komisioni nuk ka pasur mundësi që t'i realizojë kompetencat e veta ligjore, si shembull mund ta cekim raportin e vitit 2011 ku thuhet “buxheti restriktiv e pengoi Komisionin ta realizojë projektin për organizim të trajnimeve nëpër komuna, si dhe të ngrëjë fushatë mediatike për njoftim të qytetarëve me të drejtën relativisht të re të cilën e ofron Ligji”<sup>28</sup>. Vërejtjet e Komisionit dhe problemet e evidentuara, vërtetojnë se Komisioni edhe pse sipas Ligjit është i pavarur, është i varur nga pushteti i cili e krijon, përkatësisht e sjell buxhetin vjetor për punën e tij, ashtu që nuk i mundësojnë të punojë dhe t'i kryejë obligimet e veta ligjore. Vlen të theksohet se buxheti i Komisionit edhe pse i pamjaftueshëm dhe krahasuar ndërmjet viteve 2007 deri në vitin 2012 buxheti i Komisionit është ulur për 30%.

### **Hulumtim empirik**

Nuk deshta të përfundoj këtë punim shkencor pa e përmendur këtu edhe hulumtimin empirik i realizuar para disa muajve personalisht prej meje për nevojat e punimit tim të magistraturës. Hulumtimi empirik është realizuar me qëllim të dhënies së një pasqyre reale e cila mbi-zotëron në shoqërinë demokratike në RM, si dhe për t'i dhënë punimit precizitet dhe numra më të saktë nga praktika.

Mjete ndihmëse të këtij hulumtimi janë anketa dhe intervista e realizuar. Për nevojat e këtij hulumtimi janë anketuar dhe intervistuar persona të ndryshëm duke filluar prej nëpunësve shtetërorë nga disa komuna, persona zyrtarë të OJQ-ve, avokatë, student, mësues etj. Për realizimin e kësaj ankete dhe interviste janë anketuar dhe intervistuar rreth 30 persona.

Në këtë punim shkencor do të shpalosë disa prej pyetjeve në anketë dhe intervistë edhe atë:

<sup>27</sup> Член 17 став 1,2 и 3 од Закон за изменување и дополнување на Законот за слободен пристап до информации од јавен карактер (Службен весник на РМ бр.6/2010 и 42/2014)

<sup>28</sup> [http://www.komspi.mk/Content\\_Data/Baneri/Годишен%20извештај%202011.pdf](http://www.komspi.mk/Content_Data/Baneri/Годишен%20извештај%202011.pdf)

Në pyetjen e parë të anketuarit janë deklaruar si në vijim:

- A e njihni Ligjin për qasje të lirë në informata me karakter publik?

- ❖ Po 27%
- ❖ Pjesërisht 36%
- ❖ Jo 37%

- A e përdorni Ligjin për qasje të lirë në informata me karakter publik në punën tuaj të përditshme?

- ❖ Po 27 %
- ❖ Ndonjëherë 30%
- ❖ Rrallë 23%
- ❖ Jo 20%

- A i njihni organet e shtetit të cilët janë posedues të informatave me karakter publik?

- ❖ Po 34%
- ❖ Pjesërisht 43%
- ❖ Jo 23%

Në vazhdim do t'i shënojmë disa prej intervistave të realizuara.

### **Intervista nr.1.**

- A mendoni se ky Ligj është i njohur mirë për qytetarët?

Mendoj se Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik pjesërisht është i njohur për qytetarët, por shumica e qytetarëve nuk janë të njohur me ekzistimin e një ligji të këtillë.

- A mendoni se qytetarët e shfrytëzojnë mjaftueshëm të drejtën për qasje të lirë në informata me karakter publik?

Jo nuk e shfrytëzojnë mjaftueshëm Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

- A mendoni se qytetarët më shumë shfrytëzojnë rrugë jo formale për marrje të informacioneve me karakter publik se sa e shfrytëzojnë Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik?

Po definitivisht.

- A mendoni se qytetarët duhet të jenë më mirë të informuar për mundësinë të kenë qasje në informacione me karakter publik?

Nevojitet më shumë marketing rreth këtij Ligji.

- A bën përpjekje institucioni juaj t'i informojë qytetarët për të drejtën e tyre të kërkojnë zyrtarisht qasje në informata me karakter publik?

Po, mjaftueshëm.

- A ju përgjigjet institucioni juaj kërkesave dhe në çfarë afati?

Po, menjëherë.

- A ka reaguar deri tani Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata ma karakter publik kundër institucionit tuaj?

Jo, asnjëherë.

- Si e shihni rolin e Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata ma karakter publik?

Mjaftueshëm të angazhuar.

- A mendoni se në këtë mënyrë rritet besimi i qytetarëve ndaj bartësve të institucioneve publike?

Po.

- A i azhurnoni rregullisht listat e informatave me karakter publik me të cilat disponon institucioni juaj? (e obligueshme sipas nenit 9 nga Ligji)

Po patjetër.

- Kryesisht si i informon qytetarët për punën e vet institucioni ku punoni ju?

Nëpërmjet trajnimeve të herë pas here për Ligjin për qasje të lirë në informacione me karakter publik, sidomos në komuna, thuajse në gjitha komunat e RM-së.

#### **Intervista nr.4.**

- A mendoni se ky Ligj është i njohur mirë për qytetarët?

Shumica e qytetarëve në RM nuk janë të njohur mirë me këtë Ligj për arsye se nuk tregojnë interes të madh rreth këtij Ligji.

- A mendoni se qytetarët e shfrytëzojnë mjaftueshëm të drejtën për qasje të lirë në informata me karakter publik?

Në raste të caktuara po.

- A mendoni se qytetarët më shumë shfrytëzojnë rrugë joformale për marrje të informacioneve me karakter publik se sa e shfrytëzojnë Ligjin për qasje të lire në informacione me karakter publik?

Nuk besoj, pasi që gjithçka është e rregulluar me Ligj në mënyrë decide, gjithçka joformale është në kundërshtim me Ligjin dhe hidhet poshtë menjëherë.

- A mendoni se qytetarët duhet të jenë më mirë të informuar për mundësinë të kenë qasje në informacione me karakter publik?

Mendoj se po, para së gjithash duke praktikuar Ligjin.

- A bën përpjekje institucioni juaj t'i informojë qytetarët për të drejtën e tyre të kërkojnë zyrtarisht qasje në informata me karakter publik?

Në rastet kur qytetarët drejtohen deri te institucioni jonë po, gjithçka veprohet në mënyrë ligjore.

- A ju përgjigjet institucioni juaj kërkesave dhe në çfarë afati?

Po ju paraqitet kërkesa çdoherë në pajtim dhe afat me Ligjin dhe rregulloren brenda institucionit.

- A ka reaguar deri tani Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik kundër institucionit tuaj?

Jo.

- Si e shihni rolin e Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik?

Komisioni është institucion adekuat për zgjidhjen e problematikave të caktuara.

- A mendoni se në këtë mënyrë rritet besimi i qytetarëve ndaj bartësve të institucioneve publike?

Po.

- A i azhurnoni rregullisht listat e informatave me karakter publik me të cilat disponon institucioni juaj? (e obligueshme sipas nenit 9 nga Ligji)

Po.

- Kryesisht si i informon qytetarët për punën e vet institucioni ku punoni ju?

Nëpërmjet web faqes etj.

### **Përfundimi**

Liria e informimit paraqet shtyllë kryesore në zhvillimin e një shoqërie apo një vendi. Andaj mund të thuhet se nëse një vend ua mohon qytetarëve këtë tu drejtë (lexo: lirinë e informimit) vënë në pikëpyetje demokracinë dhe sundimin e ligjit.

Duke iu mundësuar qytetarëve lirinë e informimit në këtë formë ngrihet niveli i transparencës ndërmjet qytetarëve dhe pushtetit, po ashtu mundësohet llogaridhënia e pushtetit ndaj qytetarëve. Konsideroj se liria e informimit dhe liria e shprehjes janë të pavlefshme pa përhapjen e informacioneve ose thënë më mirë pa qasjen e lirë në informacione me karakter publik.

Gjatë këtij punimi mund të konstatojmë se qasja e lirë në informacione me të cilat disponojnë organet publike e përforcojnë dhe

ruajnë principin e përgjegjshmërisë së bartësve të organeve publike. Qasja e lirë në informacione me karakter publik siguron stabilitetin e institucioneve në një shoqëri demokratike.

Qasja e lirë në informacione me karakter publik është një ndër mjetet kryesore në luftën kundër korrupsionit. Kjo ngase qytetarëve iu mundësohet informimi i drejtë dhe transparent në institucione publike si dhe nëpër dokumentet financiare. Në rrethana të tilla pamundësohet, apo zvogëlohet mundësia e korrupsionit, tek zyrtarët shtetëror.

E drejta për informim ka nevojë që vazhdimisht të kultivohet edhe më tepër nga ana e institucioneve publike, pasi që transparenca ndaj opinionit publik është obligim për institucionet e një vendi.

### **Conclusion**

Freedom of information is a chief pillar in the development of a society or a country. Therefore we can say that if a country denies this right to its citizens, it endangers democracy and the rule of law.

By ensuring this right to the citizens, the level of transparency between the state and the citizens is increased, and accountability is made possible. I consider that the freedom of information and freedom of expression are useless without the spreading of information, namely without free access to public information. In this paper we can conclude that free access to information owned by public institutions enhance and preserve the principle of accountability.

Free access to public information is among the chief means in the war against corruption. This is because the citizens are provided with accurate and transparent information regarding public institutions and financial papers. Under such circumstances, the chances for corruption are rendered inexistent or are decreased.

It is necessary that the right to information always be preserved by the public institutions, for transparency towards the public is an obligation for all the institutions of a country.

### **Literatura e shfrytëzuar**

- ПАВЛОВСКА ДАНЕВА А.и Елена ДАВИТКОВСКА, (2010) Правото за слободен пристап до информации од јавен карактер, Правен Факултет Јустинијан Први, Скопје;

- Анализи и насоки од истражувањето на имплементацијата на законот за слободен пристап до информации од јавен карактер (2006-2010), Фондација отворено општество Македонија, Shkup, Tetor,2010;

- Надминување на принципите на тајност во работењето на администрацијата, (2013) Фондација отворено општество Македонија;

### **Literaturë tjetër e konsultuar**

- ГРИЗО, ГЕЛЕВСКИ, ДАВИТКОВСКИ И ПАВЛОВСКА ДАНЕВА (2008) Административно право, Скопје;

- GOGOVA Vesna dhe Klime Babunski, Programi për qasjen e lirë deri te informacionet me karakter publik, ciceroni për kërkuesit, Shkup 2006;

- GOGOVA Vesna dhe Klime Babunski, Programi për qasjen e lirë deri te informacionet me karakter publik, ciceroni për nëpunësit publik, Shkup 2006;

- Пристапот до информациите од јавен карактер е слободен, (2009) Комисија за заштита на правото на слободен пристап до информации од јавен карактер, Скопје;

- По шест години распука сидот на молкот (2013), Фондација отворено општество Македонија, Скопје;

### **Akte ndërkombëtare, të brendëshme dhe akte të brendëshme nga shtetet krahasuese**

- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë;

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të njeriut;

- Ligji për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, RM, 2006 dhe ndryshimet në vitet 2008,2010,2014;

- Ligji për lirin e shtypit, Suedi, 1776;

- Rezoluta 59, Kombet e Bashkuara, 1946;

- Deklarata Universale për të drejtat e njeriut, Kombet e Bashkuara, 1948;

### **Faqe interneti që janë konsultuar**

- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, [www.sobranie.mk/al](http://www.sobranie.mk/al)

- <http://www.mls.gov.mk/>

- Këshilli i Evropës: [www.coe.int](http://www.coe.int)

- Komisioni për mbrojtje të drejtës për qasje në informacione me karakter publik [www.komspi.mk](http://www.komspi.mk)

- Soros Maqedoni [www.soros.org.mk](http://www.soros.org.mk)

- Bashkimi Evropian: [www.europa.eu.int](http://www.europa.eu.int)

- <http://spinfo.org.mk>